



Shoqeria Ujesjelles Kanalizime
Elbasan Sh.A
NIPT L43121201L

SHENIME SHPJEGUESE PER PASQYRAT FINANCIARE TE MBYLLUR ME 31.12.2018

KUADRI KONTABEL I APLIKUAR

Në përgatitjen dhe paraqitjen e këtyre pasqyrave financiare është aplikuar kuadri kontabël i parashikuar në Standartet Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar, të shpallura nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit.

> Përshkrimi i politikave kryesore kontabël të përdorura

Aktivi, pasivi dhe pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve janë redaktuar në bazë të parimeve kontabile siç janë parimi i kujdesit, parimi i krahasueshmërisë dhe parimi i kompetencës. Gjithashtu është zbatuar parimi i përgjithshëm i vijueshmërisë në aplikimin e kriterëve të vlerësimit dhe të paraqitjes së zërave të veçante të pasqyrave financiare.

Në veçanti për zërat e ndryshëm të Pasqyrave Financiare janë zbatuar këto politika kontabile:

> Aktivët afatgjatë të trupëzuara

Aktivët afatgjatë të trupëzuara janë paraqitur me koston e tyre historike të pakësuar me amortizimin e akumuluar. Për amortizimin e tyre është përdorur metoda e amortizimit linear duke përdorur si bazë të amortizimit vlerën e tyre fillestare. Normat e amortizimit janë të njëjta me ato të vitit të mëparshëm ushtrimor.

> Aktivët afatgjatë të trupëzuara

Aktivët afatgjatë të trupëzuara janë paraqitur me koston e tyre historike të pakësuar me amortizimin e akumuluar. Për amortizimin e ndertesave dhe makinerive e paisjeve me jetegjatesi mbi 10 vjet, është përdorur metoda e amortizimit linear duke përdorur si bazë vlerën e tyre fillestare. Këto aktive janë ekspozuar në bilanc të klasifikuara sipas natyrës së tyre në kategori homogjene dhe në mbështetje të parimit të materialitetit. Normat e amortizimit janë të njëjta me ato të vitit të mëparshëm ushtrimor. Normat kontabile të përdorura për aktivët afatgjatë janë në përputhje të plotë me Standartin Kombëtar të Kontabilitetit nr 5.

Arjola Memetaj



> **Inventari**

Inventari është paraqitur me vlerën me të vogël ndërmjet kostos së tyre të blerjes apo prodhimit të llogaritur sipas metodës së mesatares së ponderuar, dhe vlerës së mundshme të realizimit të nxjerrë nga çmimet e tregut.

Normat kontabile të përdorura për inventarin janë në përputhje të plotë me Standartin Kombëtar të Kontabilitetit nr 4.

> **Kërkesat për arkëtim**

Kërkesat për arkëtim janë paraqitur me koston e tyre të amortizuar, që presupozon vlerën fillestare të tyre minus shlyerjet, minus amortizimet eventuale të akumuluar si dhe minus zvogelimet (Provizionet) nga renia në vlerë e mundësisë për ti arkëtuar.

Normat kontabile të përdorura për inventarin janë në përputhje të plotë me Standartin Kombëtar të Kontabilitetit nr 3 dhe SKK nr.6

> **Mjetet monetare**

Mjetet monetare janë paraqitur me shumën e tyre efektive e vertetuar kjo me ekstraktet e bankave dhe proces-verbalin e arkës me datë 31.12.2018

> **Detyrimet**

Detyrimet janë paraqitur me koston e tyre të amortizuar, që presupozon vlerën fillestare të tyre minus shlyerjet, minus amortizimet eventuale të akumuluar.

> **Zërat e Pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve**

Postet e pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve janë paraqitur dhe vlerësuar në përputhje me parimin e kujdesit dhe të kompetencës të parashikuara këtu në SKK.

Arjola Memetaj



Luan Dervishi

II. INFORMACIONE TE TJERA

> Aktivitet afatgjata te trupezuara

Dinamika e aktiveve te qendrueshme te trupezuara paraqitet keshtu:

Nr	Emertimi	Gjendje	Shtesa 2018	Pakesime 2018	Gjendje
		01.01.2018			31.12.2018
1	Toka	-	-	-	-
2	Rrjeti Shperndarjes	1,116,263,005	2,590,550		1,118,853,555
3	Rrjeti Kanalizimeve	153,123,054			153,123,054
4	Ndertime	168,443,853	80,211,804		248,655,657
5	Makineri,paisje,vegla	151,552,802	401,580,043		553,132,845
6	Mjete transporti	20,040,727	4,919,334		24,960,061
7	Paisje zyre mobileri	63,846,004	1,124,633		64,970,637
8	Paisje informatike	-	658,087		658,087
	TOTALI	1,673,269,445	491,084,451	-	2,164,353,896

Shoqeria ka llogaritur amortizimin e ketyre aktiveve mbi vleren fillestare. Shpenzimet e amortizimit jane brenda normave fiskale dhe jane totalisht te njohura.

Nr	Emertimi	Gjendje	Shtesa 2018	Pakesime 2018	Gjendje
		01.01.2018			31.12.2018
1	Toka				0
2	Rrjeti Shperndarjes	145,989,610	68,354,171		214,343,781
3	Rrjeti Kanalizimeve	18,711,725	6,720,566		25,432,291
4	Ndertime	22,545,553	12,070,917		34,616,470
5	Makineri,paisje,vegla	29,816,226	14,498,681		44,314,907
6	Mjete transporti	10,230,165	3,809,486		14,039,651
7	Paisje zyre mobileri	23,811,401	8,236,962		32,048,363
8	Paisje informatike		479,879		479,879
	TOTALI	251,104,680	114,170,662	0	365,275,342

Arjola Memetaj



Vlera Kontabel Neto e A.A. Materiale 2018

Nr	Emertimi	Gjendje	Shtesa 2018	Pakesime 2018	Gjendje
		01.01.2018			31.12.2018
1	Toka	0	-	-	18,867,322
2	Rrjeti Shperndarjes	970,273,395	2,590,550	48,560,399	924,303,546
3	Rrjeti Kanalizimeve	134,411,329	-	6,720,566	127,690,763
4	Ndertime	142,077,182	80,211,804	8,249,799	214,039,187
5	Makineri,paisje,vegla	98,257,211	401,580,043	10,813,088	489,024,166
6	Mjete transporti	8,124,870	4,919,334	2,123,794	10,920,410
7	Paisje zyre mobileri	39,392,031	1,782,720	8,074,270	33,100,481
8	Paisje informatike				-
	TOTALI	1,392,536,018	491,084,451	84,541,916	1,817,945,875

> Inventari

Gjendjet e inventarit paraqitet ne vleren **62.207.667** leke. Kjo vlere perbehet vetem nga materiale ndihmese ne magazine, pasi shoqeria nuk ka magazinim produktesh te gatshme. Uji qe prodhohet nuk magazinohet.

Inventari eshte vleresuar me metoden e mesatares se ponderuar.

Informacione te tjera per inventarin:

Vlera e inventarit ne magazine	62.207.667 leke
Provizione per zhvleresim inventari	nuk ka
Inventar i dhene ne garanci	nuk ka
Inventar ne ruajtje prane te treteve	nuk ka
Inventar i te treteve ne ruajtje prane shoqerise	nuk ka

Aktive të tjera financiare afatshkurta

Gjendja e kërkesave për arkëtim është **258.528.647 lekë**.

> Kërkesa të tjera të arketueshme (Investime të tjera financiare)

Gjendja e investimeve të tjera financiare në aktiv të bilancit është **15.962.270 leke**.

> Aktivët monetare

Gjendja e llogarive bankare eshte e argumentuar me ekstaktet e leshuara nga bankat per daten 31.12.2018, ndersa gjendja e arkes eshte e barabarte me procesverbalin e arkes.

Gjendja e aktiveve monetare sipas bilancit paraqitet:

- Llogari rrjedhëse në Bankë

Gjendja e aktiveve monetare

Arjola Memetaj




1. Llogari rrjedhese ne banke	51.172.294 leke
2. Gjendje arke	543.000 leke
Totali	51.715.294 leke

> Informacion për palët e lidhura

Shoqeria nuk ka pale te lidhura dhe nuk ka kryer transaksione me pale te lidhura.

> Gabime materiale të periudhave të mëparshme

Në pasqyrat financiare prezente nuk ka efekte të korigjimit të gabimeve materiale të periudhave të mëparshme.

> Ngjarjet pas datës së bilancit

Ne pasqyrat financiare prezente nuk është regjistruar ndonjë efekt financiar që vjen nga vleresimi i ngjarjeve te ndodhura pas dates se mbylljes se bilancit.

❖ REZULTATI FINANCIAR

Shoqeria gjate vitit ushtrimor 2018 ka rezultuar me humbje financiare prej **12.101.810** (dymbëdhjetëmilion e njëqind e njëmijë e tetëqind e dhjetë) **lekë** si difference e Te Ardhurave Totale me Shpenzimet Totale dhe Shpenzime te pazbritshme te realizuara gjate vitit 2018

Në përfundim të mbylljes së Bilancit të Vitit 2018 shprehim rezervat tona për rezultatin e arritur. Duhet patur parasysh që për humbjen e vitit aktual ka ndikuar me se shumti zeri i “Klienteve Debitore per Faturat e Ujit” detyrimet e prapambetura nga Shoqeria Elber Shpk, likujdimi i pageses se energjise elektrike, mos pagesa ne kohe e furnitoreve, tarifave , taksave nga stafi i meparshem dhe detyrime te Ujesjelles Fshat pas bashkimit me shoqërinë UKE sh.a. Ndërsa Gjendjen e Likuiditeteve ka qene relativisht pozitive krahasuar me vitin paraardhës si rezultat i rritjes së normes së arketimeve korrente por edhe i atyre të prapambetura.

UJESJELLES KANALIZIME ELBASAN SH.A

Elbasan me 03.07.2019

Drejtor Tregtar
Arjola Memetaj



MIRATOI
ADMINISTRATORI
LUAN DERVISHI

